



Human Rights Review Panel

Buletini informativ # 11 – tetor-dhjetor 2014

- Seanca e 23^{të} e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut
- Vendimi pasues në lëndën *Zahiti*
- Shkelja e të drejtave të njeriut në lëndën *Becic*
- Përditësim në vendime dhe komunikime
- Takim me shefin e Misionit të EULEX-it
- Takim me Panelin Këshillëdhënës për të Drejtave të Njeriut
- Fushata informuese
- Statistikat e lëndëve

Seanca e 23^{të} e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut (PShDNj)

Seanca e 23^{të} e rregullt e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut është mbajtur në Prishtinë nga data 10 deri më 12 nëntor 2014. Paneli ka shqyrtuar dymbëdhjetë ankesa dhe ka marrë vendime në dhjetë lëndë. Paneli ka gjetur një shkelje të të drejtave të ankuesit në një lëndë dhe ka marrë një vendim pasues në një lëndë tjetër. Paneli ka shpallur pesë lëndë të papranueshme dhe ka hequr nga lista e ankesave një lëndë. Dy kërkesa për rishqyrtim të ankesave janë refuzuar. Më tej, Paneli ka vendosur t'i komunikoj dy lëndë tek shefi i Misionit të EULEX-it, duke e ftuar atë për që të komentoj mbi pranueshmërinë dhe bazueshmërinë e atyre ankesave. Seanca e ardhshme e Panelit është planifikuar të mbahet kah mesi i janarit 2014.

Vendimi pasues në lëndën *Zahiti kundër EULEX-it*

Në vendimin pasues për lëndën *Zahiti kundër EULEX-it* (nr. 2012-14) Paneli ka gjetur se shefi i Misionit të EULEX-it i kishte zbatuar rekomandimet vetëm pjesërisht. Paneli ka ftuar shefin e Misionit që ta rishikoj zbatimin e rekomandimeve të mbetura. Në aplikacionin e saj parashtruar Panelit, ankuesja ka deklaruar se ishte sulmuar dhe lënduar nga një zyrtar i policisë së EULEX-it dhe si pasojë kishte qenë e paaftë të punoj për disa muaj.

Lënda *Becic kundër EULEX-it*

Në lëndën *Becic kundër EULEX-it*, Paneli ka konstatuar se EULEX-i Kosovë ka shkelur të drejtën e ankuesit sipas nenit 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (e drejta për një mjet efektiv

ankimi). Ankesa ka të bëjë me dështimin e pretenduar nga ana e EULEX-i që të hetojë uzurpimin e banesës së ankuesit. Paneli po ashtu ka bërë edhe rekomandime për shefin e Misionit për masa korrigjuese.

Vendimet e papranueshme

Pesë lëndë janë gjetur të papranueshme. Tre prej tyre (*Kadribasic kundër EULEX-it*, nr. 2014-09; *Rexhepi kundër EULEX-it* nr. 2014-19; *Selmani kundër EULEX-it*, nr. 2014-23) kanë të bëjnë me procedurat pranë gjykatave në Kosovë. Si në shumë lëndë të mëhershme lidhur me ankesa të ngjashme, Paneli ka gjetur se në parim nuk ka juridiksion për të shqyrtuar procedurat gjyqësore të gjykatave të Kosovës edhe në qoftë se gjykatësit e EULEX-it ulen në trupin gjykues. Në një lëndë (*Fazliu kundër EULEX-it*, nr. 2014-28) Paneli ka gjetur se nuk është treguar se EULEX-i ka qenë i përfshirë në ndonjë cilësi në çështjet për të cilat janë bërë ankesat. Në një lëndë tjetër, Paneli ka shpallur se nuk ka juridiksion mbi ankesën, pasi që ajo ishte parashtruar nga një punëmarrës i EULEX-it (*Beka kundër EULEX-it*, nr.2014-25).

Vendimi i heqjes së ankesës nga lista e ankesave

Në lëndën *Hyseni kundër EULEX-it* (nr. 2014-24), Paneli ka vendosur ta heqë këtë aplikacion nga lista e ankesave. Ankesa ka të bëjë me një paraburgim të dyshuar si i paarsyeshëm. Për shkak se ankuesi nuk ju është përgjigjur kërkesave të përsëritura të Panelit për informata, Paneli ka konstatuar se ai e kishte humbur interesin për ta vazhduar ankesën e tij.

Vendim mbi kërkesat për rishqyrtimin e ankesave

Paneli ka shqyrtuar dy kërkesa për rishqyrtimin e lëndëve (*Kadriu kundër EULEX-it*, nr. 2013-27 dhe *Krasniqi kundër EULEX-it*, nr. 2014-04). Në të dyja këto lëndë është konkluduar se nuk ka pasur arsye për rishqyrtim pasi që ankesat nuk kanë arritur të tregojnë ndonjë dëshmi të re që mund të kishte pasur ndonjë ndikim vendimtar në gjetjet e Panelit.

Komunikimi i lëndëve tek shefi i Misionit të EULEX-it

Paneli ka komunikuar dy lëndë tek shefi i Misionit të EULEX-it, duke kërkuar nga ai që t'i ofroj vërejtjet e tij mbi pranueshmërinë dhe bazueshmërinë e tyre. Një lëndë është parashtruar nga një i afërm i një personi të zhdukur që nga viti 1999. Ankuesi pohon se EULEX-i nuk ka kryer ndonjë hetim të duhur rreth zhdukjes së të afërmit të saj. Lënda tjetër ka të bëjë me një hetim të kryera nga prokurorët e EULEX-it. Ankuesi supozon se nuk është njoftuar zyrtarisht rreth statusit të lëndës së tij, posaçërisht rreth asaj se hetimet kishin pushuar.

Takimi me shefin e Misionit të EULEX-it

Z. Gabriele Meucci, shefi i ri i Misionit të EULEX-it Kosovë është takuar me Panelin më 10 nëntor 2014. Paneli ka njoftuar z. Meucci rreth mandatit, procedurave dhe punës së Panelit. Takimi po ashtu ishte një mundësi për të diskutuar çështjet me interes dhe shqetësim të përbashkëta.



Z. Gabriele Meucci, shef i Misionit të EULEX-it (i treti nga e majta) takon anëtarët e Panelit dhe Sekretariatit.

Takimi me Panelin Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut të UNMIK-ut (PKDNj)

Më 11 nëntor 2014, PShDNj-ja është takuar me institucionin simotër, Panelin Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut (PKDNj-në) të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK). Panelet kanë krahasuar përvojat e përbashkëta profesionale deri më tani, kanë diskutuar rreth çështjeve me interes dhe shqetësim të përbashkët dhe rreth sfidave të ardhshme.

PKDNj-ja dhe PShDNj-ja janë organet e para të themeluara të angazhuara ndonjëherë për vlerësimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut nga organizatat ndërkombëtare gjatë ushtrimit të mandatit të tyre ekzekutiv në misionet paqeruajtëse dhe përkatësisht në misionet për zbatimin e ligjit.



Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut është takuar me Panelin Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut (nga e majta në të djathtë: Joanna Marszalik, Florian Razesberger, Katja Dominik, Elka Filcheva-Ermenkova, Guénaél Mettraux, John J Ryan, Magda Mierzevska (PShDNj), Marek Antoni Nowicki, Françoise Tulkens, Christine Chinkin, Andrey Antonov, Brandon Gardner dhe Anna Cesano (PKDNj))

Fushata informuese


Sekretariati ka vazhduar fushatën informuese nëpër Kosovë. Sekretariati është takuar me z. Srecko Bogajcevic, këshilltar politik dhe shef i kabinetit në Ministrinë për komunitete dhe kthim. Takimi ishte një mundësi për të njoftuar z. Bogajcevic rreth mandatit dhe procedurave të Panelit si dhe rreth numrit të lëndëve dhe vendimeve.

Sekretariati gjithashtu ka vazhduar me takime me udhëheqës fetar dhe ka vizituar manastirin e Deçanit, ku është takuar me arkimandritin Sava Janjic, kryemurg i manastirit.



Archimandriti Sava Janjic me John J Ryan dhe Joanna Marszalik nga Sekretariati i PShDNj-së

Statistikat e lëndëve



Vizitoni faqen tonë të internetit: www.hrrp.eu



PARASHTRIMI I ANKESAVE

(Rregullat 25 dhe 26 të rregullores së punës të PShDNj-së)

Kush?

Çdo person i cili nuk punon për misionin e EULEX-it në Kosovë, i cili ankohet se ka qenë viktimë e shkeljes së të drejtave të njeriut nga ana e misionit të EULEX-it në Kosovë gjatë zbatimit të mandatit ekzekutiv të tij.

Ankuesi (personi që e bën ankesën) mund të përfaqësohet nga ndonjë avokat ose përfaqësues tjetër sipas dëshirës së tij ose saj. Në këtë rast duhet të plotësohet autorizimi.

Çka?

Paneli do t'i shqyrtojë vetëm ato ankesa që kanë të bëjnë me këto shkelje të dyshuara, të cilat kanë ndodhur në Kosovë pas datës 9 dhjetor 2008. Shkelja duhet të jetë shkaktuar nga misioni i EULEX-it në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit ekzekutiv të tij.

Paneli nuk do t'i shqyrtojë procedurat gjyqësore të kryera nga gjykatat në Kosovë.

Kur?

Ankesa duhet t'i parashtrohet Panelit brenda gjashtë muajve nga data e shkeljes së dyshuar.

Si?

Ankesa duhet të parashtrohet me shkrim. Ankesa nuk mund të bëhet me telefon. Ankuesi mund ta përdorë gjuhën angleze, shqipe ose serbe. Normalisht, ankesa duhet të plotësohet në formularin përkatës dhe të shoqërohet me dokumente dhe vendime përkatëse (nëse ka), sipas udhëzimeve në formular.

Nëse ankesa paraqitet me anë të letrës, në të duhet të përcaktohet, të paktën në formë të përmbledhur, lënda e ankesës në mënyrë që ajo të shqyrtohet më tej.

Ku?

Ankesa mund të parashtrohet në:

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut - sekretariati

Rr. Rrustem Statovci nr. 29 – 10000 Prishtinë – Kosovë

Tel: +381 (0) 38 28 2125

Ankesa gjithashtu mund të parashtrohet përmes postës elektronike në: office@hrrp.eu

www.hrrp.eu

Plotësimi i formularit për ankesë

Ankesa duhet të shkruhet qartë dhe lexueshëm, dhe mundësisht të jetë e shtypur me kompjuter.

Formulari duhet t'i përfshijë të gjitha hollësitë kontaktuese të ankuesit.

Nëse ankesa përmban fakte të dokumentuara, duhet të paraqiten kopjet e lexueshme. **Mos i dërgoni dokumentet origjinale.**

Dokumentet duhet të renditen sipas datës dhe të shënohen me numra rendor të njëpasnjëshëm dhe me një përshkrim të shkurtë (p.sh. letër, urdhër, vendim, ankesë, etj.).

Ankesës i caktohet numri i dosjes. Numri i dosjes duhet të përmendet në të gjitha korrespondencat vijuese. Nëse ankuesi tashmë e ka një ankesë, e cila është duke u shqyrtuar nga Paneli, ai/ajo duhet ta informojë Panelin lidhur me numrin e dosjes së mëparshme. Nëse ankuesi për arsye të ndryshme nuk dëshiron që identiteti i tij/saj të bëhet publik, ai/ajo duhet ta plotësojë pjesën përkatëse në formularin e ankesës.